



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**ALBANIA**

## PRESS RELEASE

### **USAID, Pastrimi i Mjedisit me Mbështetjen e Komunitetit**

**LIBRAZH, 11 DHJETOR, 2009** Dhjetëra qytetarë, organizata të shoqërisë civile, biznese dhe studentë u bashkuan me Bashkinë e Librazhdit dhe USAID-in në një përpjekje mbarëqytetëse pastrimi për të nisur një plan veprimi të ri për përmirësimin e shërbimeve.

Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore (LGPA), Bashkia e Librazhdit nisi një përpjekje për të përmirësuar shërbimet publike për komunitetin, veçanërisht për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve.

Me bashkëpunimin dhe angazhimin e qytetarëve dhe komunitetit, bashkia hartoi një Plan Veprimi për Përmirësimin e Shërbimeve për të përmirësuar shërbimin e mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve, në të cilin për herë të parë u përcaktuan treguesit e performancës në bazë të sondazheve të fundit të opinionit publik. Shërbimet e reja dhe të përmirësuara janë miratuar tashmë në buxhetin aktual të bashkisë.

Me mbështetjen e USAID-it, bashkia punoi me shkollat e mesme për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me kostot ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të degradimit të mjedisit. Në fjalën përshëndetëse me këtë rast, zyrtari i USAID-it, Stephen Herbaly, theksoi rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë qytetarët në mbajtjen dhe ruajtjen e një komuniteti të sigurt, të pastër dhe të bukur.

USAID bleu disa kosha të mëdha dhe të vegjël për mbeturinat për bashkinë si dhe disa biznese dhuruan produkte për të mbështetur këtë nismë për pastrimin e qytetit.

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA) i USAID punon me bashki partnere në të gjithë Shqipërinë me qëllim që të mbështesë zhvillimin e ekonomisë vendore, të përmirësojë qeverisjen dhe të forcojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin vendor. Bashkitë partnere të LGPA janë Fieri, Fushë Kruja, Gramshi, Korça, Kukësi, Lezha, Librazhdi, Pogradeci, dhe Shkodra.

###